



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**Komuna e Prishtinës**  
**Opština Priština –Municipality of Prishtina**



---

## **E K S T R A K T I P R O C E S V E R B A L I T**

**të mbledhjes së parë të Komitetit Konsultativ për personat me aftësi të kufizuara, mbajtur më 04.03.2021, e cila filloi në orën 13:30.**

**Në mbledhje morën pjesë: Fatime Demolli – Mustafa, kryesuese, anëtarët e Komitetit: Ramadan Salihu, Jeton Canhasi dhe Gyltene Retkoceri.**

**Munguan: Mehreme Llumnica, Ermira Shabani dhe Armend Ademi.**

**E pranishme ishte edhe Premtime Preniqi, koordinatorë e njësive për të drejtat e njeriut.**

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi **Fatime Demolli - Mustafa**, kryesuese e cila kërkoi nga anëtarët të propozojnë pikat e rendit të ditës.

**Ramadan Salihu** propozoi që si pikë e rendit të ditës të jetë: “Raporti mbi punën e KKPAAK –ës, në Komunën e Prishtinës (2020), dhe “Kërkesa e Drejtorisë së Sportit për turnirin e shahut që është i paraparë” .

**Gyltene Retkoceri** cekti te Raporti i punës: propozojë të diskutojmë më shumë rreth çështjes së punësimit që është çështje kryesore se sa ta shtyjmë këtë çështje.

**Fatime Demolli- Mustafa**, kryesuese tha: zonja Mehreme ka propozuar të hyjë si pikë e rendit të ditës “Prioriteti i personave me aftësi të kufizuara në vaksinim për COVID -19”.

Në bazë të propozimeve të anëtarëve të Komitetit lidhur me caktimin e pikave të rendit të ditës Kryesuesja konstatoi se u miratua ky

### **REND DITE:**

- 1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së pestë të Komitetit konsultativ të personave me aftësi të kufizuara;**
- 2. Raporti mbi punën e Komitetit konsultativ për personat me aftësi të kufizuara në Komunën e Prishtinës(2020);**

3. Kërkesa e Drejtorisë së Sportit për turnirin e shahut që është i paraparë;
4. Prioriteti i personave me aftësi të kufizuara në vaksinim për COVID -19;
5. Kërkesa e OJQ "Iniciativa e pavarur e të verbërve të Kosovës" drejtuar Komitetit;
6. Të ndryshme.

#### **Pika e parë**

Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së pestë të Komitetit konsultativ të personave me aftësi të kufizuara.

Kryesuesja konstatoi se njëzëri u miratua ekstrakti i procesverbalit të mbledhjes së pestë të Komitetit konsultativ të personave me aftësi të kufizuara.

#### **Pika e dytë**

Raporti mbi punën e Komitetit konsultativ për personat me aftësi të kufizuara në Komunën e Prishtinës(2020)

**Ramadan Salihu** dha sqarime lidhur me Raportin e punës së komitetit për vitin 2020 duke cekur se Raporti i ka 8 faqe, që pikat e raportit janë kryesisht të gjitha ato që i kemi bërë gjatë vitit të kaluar, ku si pikë të parë e kemi çështjen e punësimit.

Në Raport janë të dhënat, vërejtjet, rezultatet dhe rekomandimet tona si komitet që i kemi dhënë. Unë pres nga ju vërejtjet, sugjerimet e juaja, ndryshimet eventuale, sidoqoftë unë propozoj që të kalon ky raport kështu e shikojmë çka bëjmë viteve të ardhshme.

**Fatime Demolli-Mustafa**, kryesuese tha se pajtohem të kaloj ky raporti, te konkluzionet dhe rekomandimet kemi rekrutim të asistentëve për fëmijë me nevoja të veçanta.

Një rekrutim të tillë e ka bërë Forumi i Kosovës i aftësive të kufizuara që në fakt është dashur ta bëjnë Burimet Njerëzore, e kemi diskutuar sa herë por nuk kemi pasur asnjë takim të veçantë me zyrtarin Avni Zukën.

Deri ku ka shkuar kjo çështje dhe çka po ndodhë në takimin e fundit që e kemi pasur ku është thënë se në nëntor, do të hapet një konkurs i tillë, më konkretisht Albulena Ahmeti që është zyrtare për gjithë përfshirje na dha këtë informatë se nuk ka diçka të tillë.

Po ashtu u interesua për çështjen e rregullimit të tualeteve për PAK në Komunën e Prishtinës.

**Premtime Preniqi** dha sqarime duke cekur se në katin përdhes është rregulluar tualeti për PAK-ës.

#### **Pika e tretë**

**Kërkesa e Drejtorisë së Sportit për turnirin e shahut që është i paraparë**

**Fatime Demolli-Mustafa**, kryesuese tha se sa i përket kësaj kërkesë z. Ramadani e ka përgatitur një projekt-propozim për Drejtorin e Sportit, emri i projekti është "Organizimi i turnirit në shah" të cilin duhet ta organizoj komiteti, mirëpo për këtë çështje po shpresojmë se Premtimja do të na

njoftojë më gjerësisht, sepse me aq sa di unë ka kaluar afati i subvencioneve që i shpërndan Drejtoria e Sportit, dhe shikojmë se a mundemi me bërë diçka në këtë drejtim.

**Premtime Preniqi** dha sqarime duke cekur se afati është mbyllur dhe është dashur të përcillet, sepse nëse nuk gaboje afati për subvencione është dy herë në vit.

**Gyltene Retkoceri** pyeti se kur ka qenë afati për subvencionim.

**Fatime Demolli - Mustafa**, kryesuese dha sqarime duke cekur se këtë informatë e kemi dërguar në grup përmes rrjetit dhe me viber të gjithë anëtarëve të komitetit mbase mbajtjes së takimit të kaluar të komitetit.

**Ramadan Salihu** tha se ky projekt është pjesë e programit të punës që e kemi në çdo vit në Ditën e Çlirimit të Prishtinës që është paraparë turniri, ku ka qenë edhe një herë Yll Rugova, ish drejtor i drejtorisë së Kulturës, ku na patë përkrahur, por atëherë ka qenë thirrja publike e organizuar në dy pjesë.

**Premtime Preniqi** sugjeroi që nëse është propozim-projekti i gatshëm të protokollohet dhe ti dorëzohet Drejtorisë së Sportit e shikojmë ndoshta munden me futë brenda aktiviteteve të veta, kështu që bisedoj me drejtorin Fitim nëse mundet me përfshi në aktivitetit e tij.

**Fatime Demolli-Mustafa**, kryesuese tha se ne mundemi me caktuar edhe një takim fizikë me drejtorinë.

**Premtime Preniqi** tha se, si komitete mund të kërkojmë një takim paraprak, si sugjerim takoheni njëherë edhe ashtu ka kaluar afati i subvencionimit dhe sipas sugjerimeve të drejtorit gjenë mundësinë që ky projekt të futet në projektin e aktivitete të kësaj drejtorie.

**Fatime Demolli-Mustafa**, kryesuese tha se nëse na fton në takim drejtori, sugjeroi që z. Ramadani të jetë pjesë e këtij takimi pasi që është propozim-projekti i tij dhe për shkak të pandemisë mundet mos me na pranuar numër të madh të anëtarëve dhe propozoi që nëse znj. Premtime nëse është e gatshme mund të jetë prezentë në këtë takim.

## **Pika e katërt**

### **Prioriteti i personave me aftësi të kufizuara në vaksinim për COVID -19**

**Premtime Preniqi** tha se në bazë të informatave që i kemi dhe prej përvojave që po i dëgjojmë prej vendeve të tjera faktikisht personat që janë më të ndjeshëm në imunitet dhe shëndet ata po janë me prioritet d.m.th. të moshuarit e PAK-ës.

Te ne pasi që numri është i kufizuar i vaksinave duhet gjithsesi këtë çështje ta shtyjmë që PAK-ës të jetë ndoshta më përpara se të moshuarit sepse PAK-ës ka gjenerata të reja që kanë imunitet më të dobët.

**Fatime Demolli-Mustafa**, ha se ne si komitet do ti drejtohem me një shkresë Drejtorisë së Shëndetësisë.

**Premtime Preniqi** tha se si komitet do të ishte mirë që ti drejtoheni Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Rezart Halilit, ushtruesit të detyrës së drejtorit të QMF-së, që gjatë përpilimit të listave për vaksinim të jemi të informuar që t'iu sjellim listat e PAK-ës që të futen në prioritet.

Po ashtu për këtë shkresë të njoftohen përmes e-mailit edhe Kryetari Shpend Ahmeti, nënkryetari Muhedin Nushi, dhe Rezart Halili, u.d. i drejtorit në QMF.

## **Pika e pestë**

### **Kërkesa e OJQ "Iniciativa e pavarur e të verbërve të Kosovës" drejtuar Komitetit**

**Fatime Demolli-Mustafa**, kryesuese dha sqarime lidhur me kërkesën e OJQ "Iniciativa e pavarur e të verbërve të Kosovës" drejtuar komitetit që kanë kërkuar me ju ndihmuar për lokalet e punës së tyre se, Ndërmarrja publike Banesore ju është drejtuar që ti lirojnë lokalet e tyre dhe me këtë rast humbin dy vende të punës. Po ashtu dhe njëkohësisht po ballafaqohen edhe me një pjesëtar të stafit i cili është diagnosifikuar me COVID-19, këta ju janë drejtuar NPL-Banesore që nga viti i kaluar dhe nuk kanë marrë përgjigje për këtë çështje. Për këtë çështje janë të informuara edhe organet e Komunës, që kanë deklaruar se do të marrin pjesë në takimin me komitetin por deri më tani takimi nuk është realizuar.

Unë një kërkesë të tillë e kam dërguar me konsultë të Premtimes, Dren Kukaj dhe Premtim Fazliu tek njerëzit kompetentë që janë, ne nuk kemi marr asnjë përgjigje prej asnjërit si komitet.

**Gyltene Retkoceri** tha është një Organizatë "Terdes Home" në "Lagjen e Muhaxhirëve" të Shtëpia e shëndetit në përdhese ju është lëshuar një lokal fëmijëve rom, ashkali dhe zhvillojnë aty aktivitete.

**Fatime Demolli-Mustafa**, kryesuese tha ajo është edhe iniciativë e Komunës dhe i ka punësuar disa persona Komuna aty.

**Premtime Preniqi** tha këtë e kemi pasur iniciativë në fillim me Gizin me fëmijët në situatë rruge i kemi bërë disa fushata ndër fushatat ka qenë edhe kjo hapja e një qendre për fëmijë e mandej veç Gizi e përfundoi aktivitetin e vet.

E kemi hapur Terdes Home, tani objektin, ushqimin e kryen Komuna. Terdes Home e ka stafin dhe do gjëra tjera dhe është duke funksionuar mirë si qëllim i saj ka qenë mi larguar sado pak fëmijët prej rrugës, me ju dhënë një shujtë të nxehtë, me u marrë me aktivitete dhe njëkohësisht mi marrë informatat.

**Ramadan Salihu** tha se çështja e lokaleve ka qenë edhe pjesë e Planit të Veprimit. Unë jam befasuar për të mirë se Drejtoria e Mirëqenies Sociale e "Hendikosit" ja kanë rinovuar në tërësi objektin, ja kanë mobiluar, ja kanë paguar qiranë, rrymën etj dhe janë të kënaqur, ndërsa unë isha te Ejupi aty nuk kanë bërë asgjë kështu që në disa organizata po investohet në disa jo.

Sa i përket kësaj kërkesë që na është drejtuar është krejtësisht e njerëzve me titull, gjithë janë me titull mastera dhe këta po them nuk janë uzurpatorë por NPL - Banesore këtë lokal sigurisht ja kanë dhënë me vendim prandaj duhet të jetë një arsye e fortë mi larguar prej atij objekti .

**Premtime Preniqi** tha se me siguri ju ka kaluar afati i kontratës.

**Ramadan Salihu** tha se edhe nëse ju kalon afati i kontratës nuk mundet mi larguar pa ju gjetur një zgjidhje tek e fundit me ju përgjigjur NPL - Banesore është ndërmarrje publike ajo duhet me ju përgjigjur dikujt.

Nuk është që është e pavarur dhe ata duhet me ndjek vijën politike të Komunës në qoftë se Komuna OJQ-të i përkrah atëherë ato mos me bërë atë depërtim me i larguar se është një çështje e vrazhdë ndaj ati komuniteti.

**Fatime Demolli-Mustafa**, kryesuese tha se ju kam kthyer përgjigje se ju kam drejtuar Drenit me këtë kërkesë se Komitetit konsultativ i PAK-ës i ka arritur kjo kërkesë e OJQ "Iniciativa e pavarur e të verbërve të Kosovës" po ju drejtohem juve duke pasur parasysh ndihmën që ju keni ofruar OJQ-ve në nivel vendi të na shqyrtoni këtë kërkesë dhe të na informoni lidhur me këtë çështje.

Sot prapë Iniciativa e pavarur e të verbërve të Kosovës ka dërguar e-mail dhe atyre ju kam treguar se kërkesën e kam dërguar në organet kompetente të Komunës dhe jemi duke pritur përgjigje.

**Ramadan Salihu** tha se është mirë me ju dërguar këtë e-mail edhe udhëheqësve politik si Kryetarit, nënkryetarit dhe me kërkuar me pasur një takim me z. Drenin me shikuar se çka është puna pse këta janë kaq situatë të keqe.

**Fatime Demolli--Mustafa**, kryesuese tha në rregull mundemi me bërë një kërkesë me u takuar fizikisht me Drenin.

**Jeton Canhasi** tha se si plotësim duhet së pari me ditë historikun e tyre si kanë ardhur, si kanë hyrë aty, në çfarë mënyre gjallërojnë, ku i marrin mjetet.

Po ashtu tha prej mediave shihet se këto OJQ kanë bërë keqpërdorime duke mare grante duke mos i paraqit krejt andaj është mirë me kërkuar historikun e tyre.

**Fatime Demolli-Mustafa**, kryesuese tha se z. Jetoni është mirë me takuar zotëri Halilin mi treguar si Komiteti i PAK-ës kemi pasur takim dhe kemi ngritur çështjen e juaj.

Ne kemi me bërë një takim fizik me drejtorin Dren, por kërkoi nga ju informata ma të hollësishme kur jeni themeluar, kush jeni, çka jeni, si keni ardhur aty dhe pse po dëshirojnë me ju larguar.

**Ramadan Salihu** tha se nuk është për neve me u marrë me historikun e tyre, ata janë si të gjitha OJQ-të, ata janë hy me kontratë, me vendim.

**Premtime Preniqi** tha se nëse e kanë kontratën me afat të caktuar ata duhet me shfrytëzuar objektin deri në datën që e kanë me lëshuar dhe kjo punë është e kryer.

## Të ndryshme

**Jeton Canhasi** tha se e kam pasur obligim me shikuar si është situata me parkingun privato - publike që është duke u ndërtuar mbasi e kemi edhe mbikëqyrjen atje. Si informatë parkingu nëntokësor në qendër të Prishtinës është i paraparë për rreth 700 vend parkingje prej të cilëve 24 janë për PAK-ës.

Sa i përket qasjes së PAK-ës janë paraparë rampat me pjerrina më të vogla se 6% d.m.th i përshtaten kushteve dhe janë dy ashensorë që kanë me bërë bartjen.

**Fatime Demolli-Mustafa**, kryesuese pyeti sa pjerrina janë të parapara.

**Jeton Canhasi** u përgjigj se secili kate i ka pjerrinat e veta, janë të parapara me mënyrën me përqindje të PAK -ës, po ashtu janë paraparë për PAK -ën 3 tualete me dy etazhe, 2 tualete me etazh -2 dhe 1 tualet me etazh -1, këto janë të parapara për PAK-ës me projekt.

**Fatime Demolli-Mustafa**, kryesuese pyeti sa metra katror do ti ketë ky parking nëntokësor tu pas parasysh që do të jenë 700 parkingje tu përfshi edhe 24 për PAK-ën.

**Jeton Canhasi** dha sqarime.

**Fatime Demolli -Mustafa**, kryesuese pyeti a ka bazë ligjore z. Ramadan kur të bëhen parkingje të tilla sepse janë nda 700 vend parkingje për të gjithë njerëzit ndërsa janë nda vetëm 24 për PAK-ën gjë që po me duken pak, a ka ndonjë numër 100 : 1 si ndahen këto në aspektin ligjor.

**Ramadan Salihu** dha sqarime se proporcioni duhet me qenë me proporcion të popullsisë, në qoftë se është 10% popullsia atëherë këta kanë bërë ma shumë se që i takon, me siguri e kanë pas konsideratë sugjerimin e zotëri Jetonit, kanë nda më shumë.

**Jeton Canhasi** tha kjo e ka lejen, e të urbanizmit e kanë për detyrë mi përcjell normat edhe këta të urbanizmit që e kanë dhënë lejen e kanë pas parasysh këtë kusht se sa duhet bazë ajo shkon me përqindje në bazë të parkingjeve, në bazë të popullatës që kanë me parkuar aty është përqindja.

**Ramadan Salihu** tha sidoqoftë në aspektin infrastrukturorë duke i krahasuar edhe me qendrat tjera unë po them që Prishtina ka bërë punë të mirë për PAK -në, e në aspektin e punësimit e bënë të kundërtën.

*Mbledhja përfundoi në orën 14:40.*

**Procesmbajtësja:**  
**Shyhrete Islami**

**Kryesuesja e Komitetit**  
**Fatime Demolli -Mustafa**

